

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje paisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut ” - Mareveshje Kuader- Me nje OE, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Centrifuga laboratorike dhe aksesorë.

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **9 410 223 (nëntë million e katërqind e dhjetë mijë e dyqind e njëzet e tre) Lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ***Spitali Rajonal Memorial Fier*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1:

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2:

Argumentimi:*Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9:

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate **3 (tre) viteve** te fundit (**2022, 2023, 2024**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 3,700,000 lekë**, (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

Argumentimi:Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe ne piken 1 dhe piken 2/a dhe 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 : Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **1,800,000 leke** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk është më e madhe se 20% e vlerës së përllogaritur të kësaj kontrate).

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të

shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi për kriterin 2.3.1:Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [..4.] Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara; si dhe me piken 4 te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: 4. (b)Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Kriteri 2.3.2 : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose/ ekuivalent dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve të ofruar duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001-2015 ose/ ekuivalent për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Kriteri 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues ne rastet kur nuk eshte prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet te paraqese autodeklarate qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi eshte konform standarteve te cilesise ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose/ ekuivalente , te vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise dhe i njej te drejten AK per te verifikuar vetedeklarimin ne procesin e vleresimit te dokumentacionit, dhe ne rast se OE do te shpallet fitues do te paraqese certifikaten ne fjale e cila duhet te jete e vlefshme.

Argumentimi per kriterin 2.3.2 dhe 2.3.3 : Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Kriteri 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer shqip dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave, kur eshte e aplikueshme.

Argumentimi për kriterin 2.3.4 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kriteri 2.3.5 Ofertuesi të paraqesë Autodeklarate mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) per secilin artikull.

Argumentimi për kriterin 2.3.5: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Kriteri 2.3.6: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet të jene të perkthyer në gjuhën shqip dhe të noterizuara).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës (Dokumentat duhet të jene të perkthyer në gjuhën shqip dhe të noterizuara).

Argumentimi për kriterin 2.3.6: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor .*

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (**ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014**). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”**.

Kriteri 2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi kriterin 2.3.7: Këto kriterë janë vendosur nga anetari i Njesisë së Prokurimit që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpunueshmërisë së materialeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5. Objekti i prokurimit është specifik, dhe impakti që ka finalizimi me sukses i kësaj kontrate sjell përfitimi në fushën e diagnostikimit të disa lloje sëmundjesh gjenetike etj., dhe për pasojë në zgjedhjen e terapi së duhur.

Kriteri 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi kriterin 2.3.8: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Në Ligjin Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” neni 21 i tij.

Kriteri 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vetëdeklarim për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese për produktet.

Argumentimi kriterin 2.3.9: Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri 2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pajisjet dhe aksesoret shoqëruar (nëse aplikohet), në të cilën duhet të saktesojë se periudha e garancisë për çdo defekt të mundshëm teknologjik, e cila është për të paktën një vit duke filluar nga data e furnizimit të pajisjeve.

Argumentimi Kriteri 2.3.10 : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar *për të vërtetuar që malli i plotëson kërkesat e cilësisë*, bazuar në nenin 44, pika 1 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Kriteri 2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për furnizimet me mallrave/pajisjeve mjekësore sipas afatit të përcaktuar.

Kriteri 2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të konfirmoj vënien në punë të pajisjeve.

Kriteri 2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë paraprake, për garantimin e regjistrimit të pajisjes mjekësore të AKBPM-jë, pas shpalljes fitues, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Kriteri 2.3.14 Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se mallrat/pajisjet janë vendosur dhe ambalazhuara sipas standartit të prodhuesit, ku këto mallrat/pajisjet sipas objektit të prokurimit të jenë të reja, të përdorura.

Argumentimi kriterëve 2.3.11, 2.3.12, 2.3.13, 2.3.14: Kërkesat e mësipërme (vetëdeklarimet) janë përcaktuar *për të vërtetuar që malli i ofruar përmbush kërkesat e Ak (specifikimet teknike) dhe detyrimet ligjore perkatese*, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 6, gërma b, të VKM 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Kriteri 2.3.15 “Operatorit Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar të paktën një teknik/inxhinier elektrik,elektronik ose i fushës për paisjet mjekësore për te trajnuar stafin lidhur me përdorimin e paisjeve.

Për këtë duhet të paraqiten:

Kontratë punë, CV e specialistit dhe Diplome e shkolles se larte.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e emrit te Inxhinierit nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi për kriterin 2.3.15: Ky kriter vendosetne perputhje me nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së ofrimit të shërbimit objekt prokurimi.

Kriteri 2.3.16 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që pranon se në rast problemi/defekti, kompania duhet të paraqitet brenda 24 orëve nga njoftimi i AK-së për të kryer konstatimin ose riparimin.

Argumentimi për kriteret 2.3.16 : Këto kriteret vendosen ne perputhje me nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së ofrimit të shërbimit objekt prokurimi.

4. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Nr	Përshkrimi i pajisjes	Njësia
1	Paisje per parafinizimin e indeve	copë
2	Mikrotom	copë
3	Arkiva e blloqeve te parafines	copë

4	Arkiva e slideve	copë
5	Paisje per ngjyrimin automatik te lamave	copë
6	Paisje per shtrirjen e seksioneve indore te parafinizuara (banjo mari)	copë
7	Paisje per tharjen e slideve	copë
8	Termostat	copë
9	Inkubator për Laboratorin e Imunohematologjisë	copë
10	Centrifugë për kartat me xhel	copë

1.Paisje per parafinizimin e indeve – 1 cope

Sistem i integruar me modul parafinizues dhe modul ftohës, i paisur me veshje antimikrobiale.

Kapaciteti i depozites se parafines jo me pak se 5 litra e pajisur me sistem filtrimi per parandalimin e futjes se mbetjeve te parafines ne shperndares, moduli ftohes me kapacitet minimal per akomodimin e 70 blloqeve.

Kapacitet ruajtes jo me pak se 300 kaseta indore dhe 280 kallepe parafine standarte.

Te jete I pajisur me LED qe ndricon ne menyre uniforme siperfaqen e punes dhe qe ofron mundesine e rregullimit te nivelit te ndricimit.

Temperature e rregullueshme e modulit ftohes per te reduktuar plasaritjen e blloqeve indore me diapazon nga -13°C deri ne – 2°C

Te jete I pajisur me kontrollor manual per rregullimin e shperndarjes se parafines.

Te jete I pajisur me zone per mbajten e mjeteve te pune si pincetat (jo me pak se 10) ne madhesi te ndryshme.

Te permbaje nje zone per heqjen e parafines se tepert nga kaseta

Ndërfaqja e përdoruesit me ekran me prekje.

2. Mikrotom – 1 cope

Paisje gjysme automatike

-Te jete I pajisur me platforme mbajtese te qendrueshme te tehut preres per te realizuar prerje ne seksione parafine te nderlikuara

Te jete I pajisur me panel kontrolli me tastiere multi funksionale per te mundesuar kontrollin e shpejtesise, modaliteti dhe trashesin e seksionit indor.

Te ofrojme mundesine e prerjes se mostres pa kryer levizje te plote rrotulluese te mekanizmit te dores

-Te ofroje opsionin e memories mbi pozicionin e seksionimit te meparshem

-Te jete I pajisur me kontenitor mbetjesh te levizshem

- te mundesoje ndryshimin e pozicionit te panelit te kontrollit ne varesi te perdoruesit majtas ose djathtas.

-Intervali i hapit te avancimit jo me pak se 28 mm

-Trashesia minimale e seksionit indoor te perftuar te jete jo me shume se 0.5 μm

-Retraktimi jo me shume se 40 μm

-Fazat e prerjes mekanike ne intervalin 5-490 μm

- gjatesia e mbajteses se prehut preres jo me pak se 70mm per te lejuar prerjen e indit nga kaseta me permasa me te vogel/madhe se kaseta standarte

3.Arkiva e blloqeve te parafines – 1 cope

Arkiva per ruajtjen e blloqeve te parafines duhet te jete e levizshme

-Kapaciteti minimal jo me pak se 30,000 kaseta parafine

-Te jete e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare ne secilin nivel.

4. Arkiva e slideve – 1 cope

Arkiva per ruajtjen e slideve duhet te jete e levizshme

-Kapaciteti minimal 100,000 slide

-Te jete e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare ne secilin nivel.

5.Paisje per ngjyrimin automatik te lamave – 1 cope

Paisja te jete e perbere nga jo me pak se 26 stacione reagentesh lehtesisht te aksesueshme te cilat duhet te jene mjaftueshem per te realizuar disa protokolle ngjyrimi ne te njejten kohe.

Sistem i hapur per perdorim te te gjitha solucioneve nga kompani te ndryshme.

Paisja te permbaje softuer te lehte ne perdorim qe nepermjet opsione te ofruara te mundesoje perdorimin e paisjes ne kapacitetin e saj te plote dhe gjithashtu te ofroje opsionin e sistemit te kontrollit te cilesise se reagenteve.

Te ofroje mundesine e prioritizimit te lamave urgjente pa kompromentuar lamat ne proces dhe mundesine e fillimit te zbatimit te procesit te punes ne hapa te caktuara te protokollit.

Te jete e pajisur me zone per tharjen e lamave e mjaftueshme per te perballuar volum te larte te punes

Te ofroje stativ per mbajtjen e lamave (jo me pak se 10 cope), dhe jo me pak se 30 vasketa me kapacitet mbajtes te reagentit jo me pak se 300 ml dhe kapake plastike per mbulimin e vasketave qe te shmanget avullimi i reagenteve.

Aparati te jete i pajisur me filtra karboni dhe te jete i shoqeruar me 5 sete back up te filtrave.

6. Paisje per shtrirjen e seksioneve indore te parafinizuara (banjo mari) – 1 cope

Paisje me temperature te kontrolluar e perbere nga treguesi dixhital i temperatures dhe nga depozita me thellesi minimale 70 mm dhe kapacitet 3-4 litra.

Te mundesoje zhytjen e slideve ne cdo kend te depozites per marrjen me lehtesi te seksionit te parafinizuar.

Siperfaqja e veshur me shtrese antibakteriale

Te jete e paisur me sistem per ngrohje te shpejte te ujit

7. Paisje per tharjen e slideve – 1 cope

Paisja te jete e ndertuar nga treguesi dixhital i temperatures dhe siperfaqja e punes nga shufra te levizshme qe mundesoje vendosjen dhe tharjen e slideve

Siperaqja e ngrohjes te jete e veshur nga material qe krijon kontast per vizualizimin e seksioneve te parafines dhe gjithashtu veshje antimikrobiale

Te jete i paisur me sistem per ngrohje te shpejte dhe ndricim LED

8. Termostat – 1 cope

- Inkubator standard me konveksion te drejtuar
- Intervali I temperatures: +7C poshte temperatures se ambientit deri ne +300 C
- Te jete I pajisur me ekran LCD
- Dera e brendshme te jete e perbere nga xham I temperuar
- Te jete I pajisur me porte per USB
- Kontroll elektromekanik per ajrin e shkarkuar
- Volumi I brendshem ne intervalin 50-60 litra

9. INKUBATOR PER LABORATORIN E IMUNOHEMATOLOGJISE

Një inkubator i cili arrin dhe mban temperaturën 37 gradë celcius në mënyrë kostante. për inkubimin e kartave që të ketë interval të modifikueshëm te kohës sipas nevojave të laboratorit për testimet imunohematologjike

10. CENTRIFUGË PËR KARTAT ME XHEL.

- E përshtatshme për centrifugimin e kartës për testim imunohematologjik. Me nje kapacitet jo me pak se 10 karta.
- Të jetë me ekran dixhitaë i cili të tregojë kohën e mbetur nga procesi dhe numrin e xhirove.
- Xhirot të jenë të ndryshueshme e të arrinë të pakten 4000 rmp
- Koha nga 0-99 minuta ose më shumë
- Niveli i zhurmës jo më shumë se 55 db

Afati per levrimin e aparateve duhet te jete 60 dite nga data e neshkrimit te kontrates

Argumentimi per specifikimet teknike jane vendosur bazuar te procesverbalit nr. **1130/9 date 16/09/2024 te komisionit te hartimit i specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit** për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje paisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut ”** si dhe ne perputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 te **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT